

ISMAIL KADARE – SHAPER OF ALBANIAN CULTURAL AND INTELLECTUAL IDENTITY

ISMAIL KADARE – FORMËSUES I IDENTITETIT KULTUROR DHE INTELEKTUAL SHQIPTAR

Izmit DURMISHI¹

^{1*} *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

^{*} *Corresponding author e-mail: izmit.durmishi@unite.edu.mk*

Hyrje

Ismail Kadare ishte dhe mbeti një krijues i madh, një ndërtues i fjalëve që ndërtojnë ura mbi kohë dhe hapësirë. Vepra e tij, e ngarkuar me simbole dhe metafora, ishte një pasqyrë e thellë e shpirtit shqiptar dhe një kritikë e hollë e diktaturës. Në çdo fjalë të shkruar prej tij, ndihej një rrahje zemre e fuqishme, një thirrje për liri dhe drejtësi. Ai ishte një zë që nuk mund të heshte, një penë që nuk mund të ndalej. Nëpërmjet veprave të tij, Kadare na dhuroi një panoramë të gjerë të përvojës njerëzore.

Në romanet si "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", ai shpalosi absurditetin e luftës dhe kuptimin e humbjes. Në "Kronikë në gur", ai tregoi për jetën dhe historinë e Gjirokastrës, duke na bërë të ndiejmë ritmet e një qyteti të gjallë. "Pallati i ëndrrave" ishte një reflektim i thellë mbi kontrollin dhe lirinë, një pasqyrë e errët e diktaturës që ai e njohu aq mirë. Dhe në "Dosja H", ai eksploroj rrënjët e kulturës dhe identitetit tonë, duke kërkuar të zbulojë thelbin e qenies shqiptare. Kadare jetoi me një pasion të pashuar për të vërtetën dhe drejtësinë. Ai nuk e humbi kurrë besimin në fuqinë e fjalës dhe letërsisë për të ndryshuar botën.

Përmes shkrimeve të tij, ai i dha zë një populli të heshtur, duke treguar historitë dhe ëndrrat e tyre me një ndjeshmëri të jashtëzakonshme. Edhe në kushtet më të vështira, ai gjeti forcë për të krijuar, për të shprehur dhe për të luftuar për atë që besonte. Ismail Kadare është një nga shkrimtarët më të rëndësishëm shqiptar që ka kontribuar ndjeshëm në formësimin e identitetit kombëtar dhe kulturor. Ai ka qenë një mbrojtës i zjarrtë i gjuhës shqipe dhe një interpretues i jashtëzakonshëm i historisë dhe kulturës shqiptare.

Përmes veprave të tij, Kadare ka arritur të sjellë në jetë të kaluarën dhe të tashmen e Shqipërisë, duke ofruar një pasqyrë të qartë dhe të ndjeshme të realitetit shqiptar. Trashëgimia e Ismail Kadarës është e pasur dhe shumëdimensionale. Ai jo vetëm që ka kontribuar në letërsinë shqiptare dhe ndërkombëtare me veprat e tij, por gjithashtu ka luajtur një rol të rëndësishëm në formësimin e identitetit kulturor dhe intelektual shqiptar. Përmes penës së tij të fuqishme dhe zërit të tij të veçantë, Kadare ka arritur të kapë thelbin e përvojës njerëzore dhe të shprehë realitetin e një kombi në mënyra që janë të paharrueshme dhe të përjetshme.

Rreth analizës gjuhësore të romanit “Prilli i thyer”

Synimi ynë në pjesën vijuese të kumtesës është që të vëmë në dukje disa veçori gjuhësore të romanit “Prilli i thyer”, pa mëtuar që kjo të jetë analizë shteruese. Çmoj se punimet që kanë të bëjnë me analizë teksti janë më të pakta, prandaj e shoh të arsyeshme të theksoj diçka nga kjo fushë lidhur me veprën e sipërpërmendur. Romani “Prilli i thyer” është ndër veprat e rëndësishme të Kadaresë i cili edhe pse ishte botuar më herët (1978 me tjetër titull), si libër më vete u botua në vitin 2003 nga shtëpia botuese “Onufri” në Tiranë.

Rrëfimi në këtë roman bëhet në vetën e tretë. Ky roman trajton disa nga kodet e kanunit të Lekë Dukagjinit, siç janë: mikpritja, besa dhe gjakmarrja për të cilat Kadare kishte thënë se “*janë rrotat e mekanizmit të tragjedisë antike, dhe të futesh në mekanizmin e tyre është të shikosh mundësinë e tragjedisë*”. Duke pasur parasysh se kanuni po zbatohej në atë kohë, autori Ismail Kadare u inspirua për të shkruar një roman për këtë dukuri. Prilli i thyer trajton shumë tema që janë të dala pikërisht nga ky kanun.

Titulli i këtij romani shpjegon edhe domethënien pingule të tij, e cila është më e thellë sesa duket. Në fakt, autori e përdor epitetin “*i thyer*” në momentin më të përshtatshëm, nuk thyhet prilli por do të thyhet jeta e kryepersonazhit të romanit - Gjorgut në prill. Shumë lehtë mund ta zëvendësojmë epitetin “*i thyer*” me një tjetër, si p.sh. *prilli i pambaruar* ose *prilli i përgjysmuar*. Pas vrasjes ai është i sigurtë se do të jetojë i lirë vetëm tridhjetë ditë sipas “besës së madhe kanunore”.²⁹

Në pjesën vijuese të romanit lexuesit i bie në sy “perëndimi” dhe zbehja e figurës së djalit, pasi në përfundim të besës së madhe rend për te kulla e ngujimit. Kjo gjë nuk ndodh pasi më datën shtatëmbëdhjetë prill, sapo mbaron besa e madhe, Gjorgu do të vritet tek Udha e Flamurëve. Rrëfimi që e bën autori karakterizohet nga një mjeshtëri artistike dhe të lë përshtypjen sikur ke jetuar me ato doke e zakone. Kjo nënkupton shkaktun e kurorëzimit të suksesshëm të veprës. Nëpërmjet leximit të veprës jemi të aftë të zbulojmë mesazhe, ide e nënide të tij.

Mënyra e formimit të emrave në vepër

Emrat në gjuhën e sotme shqipe janë nga pjesët e ligjëratës që shtohen e pasurohen vazhdimisht. Romani “Prilli i thyer” i Kadaresë bart emra që janë formuar nga mënyra të ndryshme. Krahas këtyre në roman ka një larmi edhe të emrave të parmë. Si emra të parmë të përdorur në këtë roman do të përmendim: *udhë, dita, pushkë, besë, gjak, portë, sy, kulla, dhomë* etj. Po ashtu autori i ka kushtuar një kujdes të veçantë edhe prejardhjes së emrave. Në romanin në fjalë hasim shumë emra të prejardhur, të cilët janë formuar me parashtesim dhe prapashtesim. Emra me parashtesim do të përmendim këto: *stërgjysh, përgjakje, i porsavrari* etj.

Gjithashtu kemi një numër të konsiderueshëm të emrave që janë formuar me prapashtesa. Nga këto do të theksoja disa emra si: *varrimtarë, njerëzor, shenjim, lehtësim, gjëmëtarë, varreza* etj. Në numër më të paktë në këtë roman janë fjalët e përbëra (kompozitat). Në kreun e parë të romanit paraqiten pesë emra të përbërë. Ato janë: *gjakmarrje, keqardhje, hakmarrje, kanunshkelës, orëzi*.

Emri “*gjakmarrje*” është formuar nga emri *gjak* dhe nga emri prejfoljor *marrje*. Emri “*orëzi*” është formuar nga bashkimi i emrit *orë* dhe mbiemrit *i zi*, ndërsa “*kanunshkelës*” është formuar nga emri *kanun* dhe emri prejfoljor *shkelës*. Po kështu, në vepër nuk mungojnë edhe emrat e përngjitur, si: *ecejaket, farefis* etj. Pra, mund të themi se autori ka përdorur emra të ndryshëm për sa i përket mënyrës së formimit të tyre, por pjesën më të madhe e zënë emrat e parmë pasi ato paraqiten më të shumtë në numër se emrat e prejardhur dhe emrat e përbërë.

²⁹ ‘Besa e madhe’ sipas kanunit ishte besa që i është dhënë vrasësit se nuk do të vritet për 30 ditë.

Fjalë e shprehje me kuptime figurative

Në romanin që po shtjellojmë është e pranishme dhe polisemia.³⁰ Si fjalë dhe shprehje kryesore të figurshme të sajara nga emrat, dallojmë: emrin *bërryl* nga togefjalshi *bërryli i udhës* - këtu autori ka pasur mundësi ta përdorë shprehjen *kthesa e udhës*, që do të ishte më pak me vend. Gjithashtu nga togefjalëshi *ditë e zezë*, përdoret epiteti *e zezë* për të paraqitur një ditë të vështirë, mbiemri *e zezë* ka kuptim figurativ. Po kështu edhe krahasimi *si flaknajë e rëndë* është një shprehje e figurshme, ku emri *flaknajë* ka kuptim figurativ dhe përdoret për të treguar se si duket ujëvara në sytë e Gjorgut.

Edhe te krahasimi tjetër *si lakuriqi i natës*, emri është i përdorur për të përshkruar jetën e Gjorgut pasi të mbarojë besa e madhe. Kur bëhet fjalë për këtë thesar gjuhësor tonin, nga ky roman nuk mund t'i anashkalojmë emrat: *gjëmëtarët* dhe *çjerrjet* që paraqesin dhembjen e madhe të njerëzve për humbjen e njeriut të dashur. Mbiemrat *të çjerra* dhe *të gjakosura* janë të përdorura si epitete për të përshkruar pamjen e gjëmëtarëve. Kemi edhe togun *xhokat e zeza* të formuar nga një emër dhe një mbiemër nëpërmjet të cilit jepet informacion në lidhje me veshjet e njerëzve në ceremoni mortore; emri *grumbull* i marrë nga togefjalëshi *grumbull njerëzish*, kur dihet se hasim edhe shprehje tjera të ngjashme, si: *grumbull letrash*, *grumbull dhe*, por ndoshta më me vend do ishte të kishte përdorur togun *grup njerëzish*.

Te fjalja "*Lau gjakun e të vëllait*", folja *lau* përdoret me kuptim të figurshëm dhe më e përshtatshme do të ishte "*Mori hakun e të vëllait*", por kjo përdoret nga autori thjesht për efekt stilistik; emri "*vijat*" gjithashtu është emër polisemik sepse kemi "*vijat e tirqve*" që përdoret në roman, por kemi edhe "*vija të bardha në rrugë*", "*vijë e lakuar*", por mund të jetë edhe folja *vij* në kohën e pakryer; emri "*copa*" gjithashtu mund të ketë më shumë kuptime. Themi kështu pasi kemi "*copë mëndafshi*", "*copë toke*" ose shprehja "*u bë copë-copë*".

Nga shprehjet e figurshme dhe emocionale, që janë përdorur në roman, po veçojmë: "*maskë e përgjakur*", ku aludohet në fytyrat e njerëzve që i kanë të gjakosura nga çjerrjet; "*si magmë vullkani*", është figurë letrare e krahasimit me të cilën autori krahason rënien e muzgut; *i miri i kokës*, *i bukuri* - kështu tregon gjyshja për nipin e vvarë, pra nëpërmjet emërimit të mbiemrave autori e shpreh qartë dashurinë që ka gjyshja për nipin. Edhe te metafora "*taksa e gjakut*", autori ka bërë një komponim të drejtë të emrit *taksë* me emrin tjetër të rasës gjinore "*e gjakut*" që ka arritur efekt të fuqishëm emocional.

Sipas kanunit të Lekë Dukagjinit, ai që bënte vrasje për hakmarrje duhet të paguante një taksë, e ashtuquajtura "*taksë gjaku*". Shumë emocional është edhe urimi për fëmijët e porsalindur "*me jetë gjatë e ta vraftë pushka*"!

Këtë autori e shpreh duke përdorur fjalët e duhura, edhe pse në pamje të parë duket si mallkim, në Mirditë kishte domethënie tjetër, pra ishte urim. Për banorët e Malcisë nuk ishte e denjë të vdisje nga një sëmundje apo aksident, por vetëm të vdisje nga pushka ishte vdekje e ndershme. Në shprehjen idiomatike "*I shkrepë në kokë të dilte*" gjithashtu kemi atë shprehje të figurshme, të përdorur me një arsye imediate, pasi në disa raste të tjera përdoret folja *erdhi*, si p.sh. *i erdhi në kokë të dilte*.

Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj

Ruajtja dhe pasurimi i gjuhës sonë amtare është ndër detyrat tona më të rëndësishme për mbarëvajtjen tonë kombëtare. Një porosi të tillë fisnike na e kanë lënë edhe mendjet më të ndritura të kombit. Pastrimit të shqipes, ashtu si edhe pasurimit të vazhdueshëm të saj i kishin kushtuar kujdes të veçantë edhe rilindasit tanë të mëdhenj, si: Konstantin Kristoforidhi, Naim e Sami Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vreto etj. Ata kishin kërkuar me ngulm që të mos përdoren fjalë të huaja në shqipen, - sidomos turqizmat, greqizmat e sllavizmat, - dhe në vend të tyre të

³⁰ Polisemi d.m.th.fjalë me shumë kuptime

përdoreshin fjalë të shqipes nga gurra popullore ose të krijoheshin fjalë të reja nga vet brumi i saj.

Më vonë, një porosi të tillë e kishin realizuar në krijimtarinë e tyre edhe korifentët e gjuhësisë dhe letërsisë profesor Eqrem Çabej e Ismail Kadare, ndërkaq sot po e çojnë në vend të gjithë dashamirët e shqipes, lëvruarit e saj – gjuhëtarët e shkrimtarët me krijimtari të pasur. Në veprat e tija letrare, kolosi ynë Ismail Kadare ka përdorur një numër të madh fjalësh të shqipes të cilat i ka krijuar vetë, duke u mbështetur në gjuhën popullore dhe brumin e saj. Që në shkrimet e tija të hershme e deri në ato që shkruan së fundmi, vërejmë një sasi mjaft të madhe fjalësh, të cilat ai i përdor për të mënjeluar fjalët e huaja të cilat po e ngulfatin tej mase shqipen, e në vend të tyre përdor fjalë të brumit të shqipes.

Të tillat tani më janë të njohura botërisht dhe po bëhen normë e shqipes standarde. Sa për ilustrim, po nënvizojmë disa të tilla: *mëtoj* në vend të pretendoj, *Flamurtari* në vend të Bajraktari, *flamurbajtës* në vend të bajraktar, *dërgatë* në vend të delegacion, *barnatore* në vend të farmaci, *ndërdije* në vend të subkoshiençë, *njeridashës* në vend të human, *risi* në vend të novitet, *kanuntar* në vend të konstitucionalist, (i) *jashtarsyeshëm* në vend të iracional, *mishtar* në vend të kasap, *kundërthënës* në vend të kontradiktot, *endacak* në vend të nomad, *fundshtrëjë* në vend të dysHEME, *atdhësia* në vend të patriotizmi, *ballinë* në vend të kopertinë, *bujtinar* në vend të hanxhi, hotelxhi, *bujtja* në vend të akomodimi, *dehashpirt* në vend të entuziast, *dyfetari* në vend të bikonfesionalizëm, *dypërmashe* në vend të bidimensionale, *dysia* në vend të dublimi, *erëmirimi* në vend të aromatizimi, *flijimtari* në vend të sakrificë, *foltore* në vend të tribunë, *fortafolës* në vend të altoparlant, megafon, *gënjim* në vend të iluzion, *gufmimi* në vend të entuziazmi, *hamendësia* në vend të intuïta, (i) *jashtudhshëm* në vend të ekstravagant, *oborrësi* në vend të kortezi, *kombëtarist* në vend të nacionalist, *kumbueshëm* në vend të harmonikisht, *kumt* në vend të mesazh, komunikatë, *kumtim* në vend të komunikim etj.

Përfundimi

Duke vërejtur me kujdes gjuhën e pasur e të begatë të autorit në romanet e tij përgjithësisht, si dhe gjuhën që ka përdorur në veprën e përmendur që kemi objekt shtjellimi, mund të përfundojmë se, autori përrnes shprehjeve të përmendura frazeologjike dhe atyre stilistike ka rritur dukshëm vlerën artistike të prozës, duke i dhënë asaj një ngjyrim tërheqës dhe shumë emocionues.

Këto njësi frazeologjike që u shënuan më sipër si dhe disa të tjera në vepër, janë nga ata që konsiderohen si pronë e përbashkët e mbarë shqipes. Në këtë vepër vërehet një përpunim i kujdesshëm gramatikor sipas normave drejtshkrimore të shqipes standarde që është karakteristike, jo vetëm për emrat, por edhe për njësitë e tjera leksikore. Duke e studiuar me kujdes prozën e tij në përgjithësi, po edhe romanin e përmendur më sipër, konstatoj se Ismail Kadare, jo vetëm që i njeh mirë normat letrare artistike, por edhe paraqitet si njohës i mrekullueshëm i gjuhës standarde shqipe.

Referencat

- [1]. Çeliku, Arbër, *Koherenca tekstore*, Asdreni, Shkup, 2005.
- [2]. Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Onufri, Tiranë, 2003.
- [3]. Mujaj, Hasan, *Gjuhësia e tekstit*, Faik Konica, Prishtinë, 2004.
- [4]. Topalli, Tefë, *Gjuhësi teksti*, ISA, Shkodër, 2011.
- [5]. Thomaj, Jani, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, ETMMKSAK, Prishtinë, 1978.
- [6]. Thomai, Jani, *Teksti dhe gjuha*, SHBLU, Tiranë, 1992.